



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy  
Supporting freedom around the world

# BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICIONI I TETË

NËNTOR 2018

BKS 2018  
FSK

PK

AKI







# BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

EDICIONI I TETË

Autore: Donika Marku

Metodolog: Mentor Vrajolli, Senior Researcher

Rishikimi i Brendshëm: Mentor Vrajolli

---

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve që botohen nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutem kontaktoni në: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të nxjerra nga të anketuarit dhe ai vetëm demonstroi mënyrën se si njerëzit i perceptojnë institucionet. Raporti në asnjë mënyrë nuk paraqet ndonjë vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve të përfshira në këtë studim. Ai do të shërbejë si instrument për të adresimin e mangësive të mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit Ndhimja Kombëtare për Demokraci (NED)

# PËRMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| MIRËNJOHJE   | 6         |
| LISTA E SHKURTESAVE  | 7         |
| GJETJET KRYESORE TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË   | 8         |
| <b>KAPITULLI 1 - BKS 2018: BESIMI NË INSTITUCIONE TË SIGURISË, DREJTËSISË DHE QËNDRORE</b>                             | <b>9</b>  |
| 1.1 BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË   | 10        |
| 1.2 BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË   | 14        |
| 1.3 BESIMI NË INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE  | 16        |
| 1.4 BESIMI NË INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE   | 21        |
| <b>KAPITULLI 2 - BKS 2018: KËRCËNIMET KRYESORE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME SIÇ PERCEPTOHEN NGA QYTETARËT E KOSOVËS</b> | <b>22</b> |
| 2.1 PERIMETRI I SIGURISË   | 25        |
| <b>METODOLOGJIA</b>  | <b>26</b> |
| ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?  | 26        |

# MIRËNJOHJE

QKSS dëshiron t'u shpreh mirënjohje të veçantë anëtarëve të ekipit për kontributin e tyre të çmuar në hulumtimin në terren. Ekipi i BKS 2018 përbëhej nga:

## BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË



# LISTA E SHKURTESAVE

|              |  |
|--------------|--|
| <b>KK</b>    | Kuvendi i Kosovës  |
| <b>BE</b>    | Bashkimi Evropian  |
| <b>EULEX</b> | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë |
| <b>QK</b>    | Qeveria e Kosovës  |
| <b>FAK</b>   | Forcat e Armatosura të Kosovës                               |
| <b>QKSS</b>  | Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë                      |
| <b>KFOR</b>  | Forca e NATO-s në Kosovë                                     |
| <b>AKI</b>   | Agjencia e Kosovës për Inteligjencë                          |
| <b>PK</b>    | Policia e Kosovës  |
| <b>BKS</b>   | Barometri Kosovar i Sigurisë                                 |
| <b>FSK</b>   | Forca e Sigurisë së Kosovës                                  |
| <b>NATO</b>  | Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior                  |
| <b>NED</b>   | Ndihma Kombëtare për Demokraci                               |
| <b>RAE</b>   | Romë, Ashkali dhe Egjiptas                                   |

# GJETJET KRYESORE TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një mjet i veçantë, përmes të cilit Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mat perceptimet publike. Edicioni i tetë i BKS-së përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë mat perceptimet e qytetarëve lidhur me besimin në institucionet e sigurisë, drejtësisë, si dhe në institucione qendrore, ndërsa kapitulli i dytë regjistron perceptimet e qytetarëve lidhur me rreziqet e brendshme si dhe kërcënimet të cilat e kanosin Kosovën.

Perceptimet e besimit në institucionet e shtetit dhe perceptimet lidhur me sigurinë dhe rreziqet mund të dallojnë varësisht nga etnia, gjinia, zona dhe rajoni i banimit. Krahas kësaj, raporti përmban edhe analiza të kombinuara të të dhënave përtej interpretimit të përgjithshëm, gjë që i mundëson publikut të kenë një pamje të qartë dhe pikëpamje më kuptimplote lidhur me besimin e qytetarëve në institucione dhe perceptimet e rreziqeve. Lidhur me këtë, analizimi i rezultateve rreth besimit bazuar në zona dhe rajone specifike, në përkatësinë etnike, gjininë, si dhe të dhënat e tjera plotësuese lidhur me të anketuarit, do t'i mundësojë audiencës që të kuptoj, analizoj si dhe të arsyetoj mendimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe drejtësinë.

Krahas rezultateve të BKS 2018 dalin edhe gjetjet kyçe:

- Qytetarët e Kosovës u besojnë institucioneve të sigurisë më shumë se atyre të drejtësisë ose atyre qendrore;
- Forca e Sigurisë së Kosovës përsëri është rradhitur si institucioni më i besueshëm në Kosovë;
- Institucionet e drejtësisë vazhdojnë të kenë besim të ulët edhe pse është shënuar një rritje e vogël e besimit (2 pikë të përqindjes) në të dy institucionet;
- Institucionet qendrore si Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës vazhdojnë të gëzojnë besim të ulët të qytetarëve, përderisa besimi në institucionet komunale shënon besim më të lartë;
- Qeveria e Kosovës është listuar si institucioni më i jobesueshëm për qytetarët e Kosovës;
- Besimi i qytetarëve ndaj EULEX-it vazhdon të jetë shumë i ulët krahasuar me KFOR-in, i cili listohet si institucioni i dytë më i besueshëm;
- Barometri nuk ka regjistruar ndonjë ndryshim të madh në rezultate sa i përket lidhshmërisë në mes besimit si dhe zonës së vendbanimit. Po ashtu, nuk është vërejtur ndonjë ndryshim i madh sa i përket regjioneve, përveç në Mitrovicë të Veriut ku besimi në institucione kosovare është dukshëm më i ulët. Ngjashëm edhe tek analizimi i lidhshmërisë së besimit me përkatësi etnike, Kosovarët Serb vazhdojnë të kenë besim të ulët në institucionet e Kosovës.
- Gratë u besojnë institucioneve të drejtësisë si dhe atyre komunale më shumë se burrat;
- Të anketuarit i shohin korrupsionin, papunësinë, krimin e organizuar si rreziqet më të mëdha të brendshme të Kosovës. Mirëpo, shqetësim i madh është vërejtur edhe për ndarjen e Kosovës si dhe autonominë e veriut.
- Të anketuarit në zona rurale janë më të shqetësuar rreth rreziqeve të brendshme të Kosovës se sa të anketuarit në zona urbane;
- Responentët Kosovarë Serb ndihen më pak të kërcënuar nga të gjitha rreziqet nacionale të sigurisë se sa responentët Shqiptar; mirëpo, të dy etnitë shprehën shqetësim të theksuar lidhur me krimin e organizuar;
- Perimetri i sigurisë ka treguar që të anketuarit ndihen më të sigurt në shtëpitë e tyre ose në lagje, krahasuar me fshatin/qytetin ose Kosovën në përgjithësi.



# BKS 2018: BESIMI NË INSTITUCIONE TË SIGURISË, DREJTËSISË DHE QËNDRORE

Edicioni i Rregullt i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) mat besimin e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve kryesore të sigurisë dhe drejtësisë në vend. QKSS përpiqet të mat besimin për faktin se besimi është treguesi më i denjë për të matur dhe vlerësuar ndikimin e përgjithshëm të performancës së institucioneve kosovare të sigurisë dhe drejtësisë. Përveç kësaj, besimi është një masë e rëndësishme për të matur (pa)kënaqësinë e përgjithshme të qytetarëve të Kosovës, duke regjistruar nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve qeveritare qendrore dhe komunale. Po ashtu, besimi pasqyron nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur qendror dhe lokal si dhe me elitën e përgjithshme politike në Kosovë.

Duhet theksuar se niveli i besimit ose mosbesimit ndaj disa institucioneve ose sektorëve nuk është gjithmonë i bazuar në cilësinë e performancës ose në mungesën e saj. Kjo ngase shumë shpesh niveli i besimit ose mosbesimit ndaj institucioneve ose sektorëve bazohet në performancën e dobët të perceptuar të qeverisë dhe në mungesën e llogaridhënies së elitave politike.

Ky edicion i hulumtimit të BKS-së e ka matur besimin e qytetarëve në gjithsej 10 institucione kyçe të sigurisë dhe drejtësisë. Raporti i kategorizon këto institucione në këto katër grupe:


- Institucionet e sigurisë (Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK) dhe Agjencioni Kosovar i Intelgjencës (AKI)
- Institucionet e drejtësisë (Prokuroria dhe Gjykata)
- Institucionet e zgjedhura (Kuvendi i Kosovës (KK), Qeveria e Kosovës (QK) dhe Komunitat)
- Institucionet ndërkombëtare (KFOR dhe EULEX)

# 1.1 BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË

Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të besuarat në Kosovë. Ngjashëm me edicionin e kaluar, 77% e respondentëve janë shprehur se i besojnë FSK-së, ku prej tyre

gati gjysma kanë thënë se kanë besim të lartë në këtë institucion. Në anën tjetër, vetëm 12.5% të respondentëve janë shprehur se nuk i besojnë FSK-së.


## Besimi në FSK




## Besimi në PK




## Besimi në AKI




### Besimi në FSK sipas gjinisë



### Besimi në FSK sipas kombësisë




### Besimi në FSK sipas rajonit




Sipas të gjeturave të BKS 2018, Policia e Kosovës (KP) vazhdon të jetë një institucion i besueshëm në sytë e qytetarëve. Më shumë se gjysma e të anketuarëve (61%) janë shprehur se i besojnë PK-së. Nga këta 61%, 30% kanë thënë se i besojnë PK, ndërsa pjesa tjetër (31%) janë shprehur se i besojnë shumë PK-së. Ndërsa, 10% e të anketuarëve janë

deklaruar se nuk kanë besim në këtë institucion. Përderisa përqindja e respondentëve që kanë shprehur besimin e tyre në PK nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar, është vërejtur një rënie prej 6% e të anketuarve që janë shprehur se nuk i besojnë PK-së.


### Besimi në PK sipas gjinisë



### Besimi në PK sipas vendbanimit



### Besimi në PK sipas kombësisë




### Besimi në PK sipas rajonit




Për qytetarët e Kosovës, Agjencia Kosovare e Intelgjencës (AKI) qëndron si institucioni më pak i besueshëm i sigurisë. Jo vetëm, këtë vit është vërejtur një rënie e madhe e besimit të qytetarëve në AKI, krahasuar me vitin e kaluar. Përderisa vitin e kaluar 37% e të anketuarëve<sup>1</sup> janë shprehur se i besojnë AKI-së, këtë vit vetëm 20% kanë shprehur besimin e tyre për këtë institucion. Për më tepër, vetëm 4% e të anketuarëve kanë thënë se i besojnë shumë këtij institucioni.

### Besimi në AKI sipas gjinisë




### Besimi në AKI sipas kombësisë



AKI-ja është institucioni i sigurisë më së paku i njohur për qytetarët, gjë që ka ndikim edhe në besimin e tyre në këtë institucion. Po ashtu, rasti i ekstradimit të gjashtë turqve që shpui deri në dorëheqjen e drejtorit të AKI-së mund të ketë ndikuar në këtë ulje të besimit të qytetarëve në AKI.

### Besimi në AKI sipas rajonit



1 Vrajolli, M. (2018) "Barometri Kosovari i Sigurisë: Edicioni i Shtatë" Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë [Online] E çasshme në [http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO\\_SECURITY\\_BAROMETER\\_7\\_SHQIP\\_FINAL\\_163414.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_SHQIP_FINAL_163414.pdf)

## 1.2 BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË


Institucionet e Drejtësisë vazhdojnë të jenë më pak të besueshme se ato të sigurisë. Edhe pse është vërejtur një rritje e vogël e besimit në të dy institucionet (2 pikë të përqindjes), rezultatet e BKS kanë treguar se në vitin 2018, besimi i qytetarëve të Kosovës në këto institucione vazhdon të jetë i ulët. Ky vështrim negativ vlen për prokurorinë si dhe gjykatat, si dy shtyllat kryesore të sektorit të drejtësisë.

Këtë vit, 31% të të anketuarëve kanë shprehur besimin e tyre në Prokurori, ndërsa 40% kanë shprehur mosbesimin e tyre në këtë institucion. Përderisa nuk është vërejtur ndonjë rritje ose ulje në besimin ndaj Prokurorisë, Barometri ka regjistruar një rritje në pikët e përqindjes së qytetarëve që kanë shprehur besimin e tyre në Gjykata. Në Barometrin e vitit të kaluar 25% e të anketuarve u deklaruar se u besojnë gjykat-


ave, ndërsa këtë vit 27% thanë se u besojnë gjykatave. Megjithatë, duke pasur parasysh rolin e këtyre institucioneve të sigurisë në përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, një rritje kaq e vogël është e pamjaftueshme.

Përvoja personale qëndron si element kyç në perceptimin e qytetarëve rreth besueshmërisë. Mirëpo, sa i përket besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, ky besim bazohen më shumë në faktor dhe elemente të ndryshme se sa vetëm në përvojën e tyre personale me këto institucione. Për më shumë, ky perceptim i ulët në institucione të drejtësisë mund të jetë i lidhur me punën e këtyre institucioneve në luftimin e korrupsionit dhe dukurive të tjera kriminale që vazhdojnë të dëmtojnë Kosovën.


### Besimi në GJYKATA




### Besimi në PROKURORI




### Besimi në Gjykata sipas gjinisë




### Besimi në Prokurori sipas gjinisë



### Besimi në Institucionet e sigurisë sipas rajonit



### Besimi në Institucionet e sigurisë sipas kombësisë



## 1.3 BESIMI NË INSTITUCIONET QENDRORE DHE LOKALE

BKS 2018 ka matur perceptimet e qytetarëve ndaj institucioneve kryesore qendrore dhe lokale të zgjedhura në mënyrë demokratike në Kosovë. Ngjashëm si në vitet e tjera, fokusi primar i kësaj pjese të hulumtimit ishte që të mas perceptimin e qytetarëve për Kuvendin e Republikës së Kosovës (Kuvendi), Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe autoritetet komunale.

Fokusi në këto tri institucione kyçe të zgjedhura në mënyrë demokratike lidhet me rolin e tyre aktiv që përfshinë sektorët e sigurisë dhe drejtësisë. Përveç kësaj, këto tri institucione janë drejtpërdrejt përgjegjëse për të ofruar siguri socio-ekonomike për qytetarët. Prandaj, matja e perceptimeve të qytetarëve ndaj këtyre tri institucioneve është një objektivi i rëndësishëm i këtij raporti. Përkundër rolit të tyre shumë të rëndësishëm, të dhënat e BKS-së tregojnë se besimi ndaj këtyre institucioneve vazhdon të mbetet shumë i ulët. Veçanërisht Kuvendi dhe Qeveria vazhdojnë të mbesin ndër institucionet më pak të besueshme në Kosovë.

Të dhënat e BKS tregojnë se vetëm 15% e të anketuarëve i besojnë Kuvendit të Kosovës. Shihet se ka një rritje të besimit në këtë institucion prej tre pikë të përqindjes. Mirëpo, më shumë se gjysma e të anketuarëve (65.7%) kanë thënë se nuk kanë besim në këtë institucion, duke lënë të kuptohet që qytetarët janë jashtëzakonisht të pakënaqur me punën e këtij institucioni. Jo vetëm, hulumtuesit e terrenit të BKS kanë treguar se qytetarët kishin tendencë të ndajnë disa deputetë dhe të shprehin besimin në ta; mirëpo për ta, ky numër i vogël i deputetëve që përkushtuar është mjaftë i kufizuar.<sup>2</sup>

Qëndrim i përafërt negativ është vërejtur edhe në besimin ndaj Qeverisë së Kosovës. Ngjashëm me vitin e kaluar, vetëm 14% e të intervistuarëve kanë shprehur besimin e tyre në Qeverinë e Kosovës. Në anën tjetër, 64.7% të të anketuarëve kanë thënë se nuk i besojnë Qeverisë së Kosovës.

Prandaj, Qeveria e Kosovës rradhitet si institucioni me besueshmërinë më të ulët nga të gjitha institucionet e matura në këtë edicion të barometrit. Kjo mungesë e besimit në këto dy institucione themelore është alarmante dhe tregon se këto institucione kanë dështuar t'u dëshmojnë qytetarëve se janë duke punuar mjaftueshëm për të bërë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar.

Një besim kaq i mangët i qytetarëve krahas këtyre institucioneve mund të ketë ardhur si pasojë e krizës institucionale të krijuar që në fillim të mandatit kur Kuvendi ngeci në përzgjedhjen kandidatit për pozitën e kryeparlamentarit dhe kryeministrit, që shpiu në bllokim të institucioneve. Bllokimi ky që ndikoi në mosfunksionimin e institucioneve për një periudhë të gjatë, duke ndikuar në jostabilitet politik, mungesë të udhëheqjes nga pozita dhe opozita. Po ashtu, ky bllokim reflektoi mungesë të vullnetit politik për ecjen e proceseve të rëndësishme për Kosovën. Paralelisht, ky besim i ulët në Kuvend dhe Qeveri mund të jenë të lidhura me gjendjen e dobët ekonomike të vendit, izolimin aktual të Kosovës- ngecja e procesit të liberalizimit të vizave, dialogut me Serbinë dhe mos-anëtarësimi në organizata dhe mekanizma ndërkombëtare. Mirëpo, një çasje tjetër vërehet ndaj institucionet lokale.


Institucionet lokale, komunale, vazhdojnë të jenë më të besueshme se ato qendrore. 39.1% e të anketuarëve kanë thënë se janë të kënaqur me punën e komunave. Sipas hulumtuesve në terren, qytetarët reflektojnë besim në komuna, besim ky që kryesisht lidhej me shërbimet e komunave.<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Fokus grupi për BKS 2018, nëntor 2018, QKSS


<sup>3</sup> Po aty;




### Besimi në Kuvendin i Kosovës




### Besimi në Qeverinë e Kosovës




### Besimi në Institucionet lokale



### Kuvendin e Kosovës




### Qeverinë e Kosovës




### Institucionet lokale




### Besimi në institucioneve qendrore dhe lokale sipas kombësisë




### Besimi në institucioneve qendrore dhe lokale sipas rajonit





### Niveli i besimit në institucioneve qendrore dhe lokale bazuar në të ardhurat mujore e të anketuarve





## 1.4 BESIMI NË INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE


KFOR vazhdon të mbetet një prej mekanizmave me të besueshëm ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës, edhe 19 vite pas zbarkimit të tij në Kosovë. Ngjashëm me vitin e kaluar, 68% e të anketuarëve kanë shprehur besimin ndaj misionit të NATO-s. Në anën tjetër, 6% e qytetarëve kanë treguar që nuk i besojnë KFOR-in. Paralelisht, vërehet se niveli më i ulët i besimit në KFOR është regjistruar tek Kosovarët Serb (8%), përdërisa të gjitha minoritetet tjera kanë besim të madh në këtë mekanizëm. Është e qartë se qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mbështesin praninë e NATO-s në Kosovë. Përdërisa qytetarët e shohin KFOR-in si lehtësues të tranzicionit të Kosovës drejt integritimit në NATO dhe e konsiderojnë misionin e KFOR-it si mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës, një qëndrim kaq pozitiv i qytetarëve nuk është vërejtur në misionin e EULEX-it.

Ngjashëm me vitin e kaluar, qytetarët vazhdojnë të kenë nivel të ulët të besimit ndaj EULEX-it. Sipas të gjeturave të BKS 2018, më pak se çereku i të intervistuarve (24%) i besojnë EULEX-it. Në anën tjetër 32% e të intervistuarit nuk i besojnë këtij misioni ndërkombëtarë. Besimi më i ulët në EULEX-in është regjistruar tek Kosovarët Serb, ku vetëm 3.5% e qytetarëve kanë thënë se i besojnë këtij misionit. Krahas kësaj Mitrovica e Veriut është regjioni me besimin më të ulët në këtë institucion. Çka vërehet këtë vit është se burrat kanë besim më të madh në këtë institucion se gratë-me dallim tetë pikë të përqindjes. Padyshim se një nivel kaq i ulët i besimit në EULEX vjen si rrjedhojë e dështimit të këtij misioni në kryerjen e detyres së tij parësore, në përfundimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

### Besimi në Institucionet ndërkombëtare



### Besimi në Institucionet ndërkombëtare sipas etnisë



---

# BKS 2018: KËRCËNIMET KRYESORE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME SIÇ PERCEPTOHEN NGA QYTETARËT E KOSOVËS

---

Përveç matjes se besimit ndaj institucioneve të sigurisë, BKS 2018 ka bërë edhe matjen e perceptimeve të qytetarëve të Kosovës edhe lidhur me kërcënimet kryesore të brendshme dhe të jashtme të sigurisë. Në mënyrë që të kemi një pamje më kuptimplotë se çka i frikëson qytetarët, matja e kërcënimit të perceptuar është bërë duke iu ofruar të anketuarve edhe pyetje të hapura edhe pyetje të mbyllura. Përmes pyetjeve të hapura të anketuarve iu kërkua që të shkruanin se cilat janë rreziqet dhe kërcënimet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Mirëpo, përgjigjet e marra nga të anketuarit në pyetjet e hapura ishin pothuajse të njëjta me ato të parashikuara në pyetjet e mbyllura.

Kërcënimet më të përmendura që u theksuan nga të anketuarit përmes pyetjeve të hapura lidheshin me: situatën kritike ekzistuese socio-ekonomike dhe situata politike. Të anketuarit shpesh përmendën korrupsionin, papunësinë, krimin e organizuar, marrëdhëniet me Serbinë, krimi ordiner dhe ekstremizmi i dhunshëm si kërcënime kryesore. Po ashtu, të anketuarit përmenden edhe tensionet ndëretnike dhe situata politike në mes Kosovës dhe Serbisë në arenën ndërkombëtare. Mirëpo, ndarja e Kosovës si dhe shkëmbimit të territoreve nuk ishin shqetësimet kyçe të qytetarëve në pyetjen e mbyllur.


Në pyetjet e mbyllura, shumica dërmuese e të anketuarëve e listuan korrupsionin (89.1%), papunësia (89.0) dhe krimi i organizuar (88%) si kërcënimet më të rrezikshme të brendshme për Kosovën. Duhet përmendur se qytetarët po ashtu shprehën shqetësim të madh lidhur me ndarjen e Kosovës dhe autonominë e Veriut. Pesë nga gjashtë respondentë (84%) listuan ndarjen e Kosovës si dhe Autonominë e Veriut (82%) si kërcënime kyçe të vendit. Ndryshe nga edicioni i vitit të kaluar, këtë vit kishte një rritje prej 13 % të të anketuarëve që shohin rreziqet natyrore si

rreziqe kyçe. Në anën tjetër, është vërejtur një ulje prej 5% në numrin e të anketuarëve që listuan ekstremizmin e dhunshëm si kërcënim të madh të brendshëm (70%). Në pyetjet e mbyllura, qytetarët shprehën shqetësimin e tyre rreth të gjitha rreziqeve të listuar, megjithatë, disa nga rreziqet u panë si më të dëmshme se të tjerat. Për këtë arsye, është e nevojshme të analizohet se cilat rreziqe i listojnë si më të rrezikshme qytetarët në zona, rajone të ndryshme, si dhe cilat rreziqe kanë listuar respondentët e etnive dhe gjinive të ndryshme si më të rrezikshmet.


### Kërcënimet kryesore




Kërcënimet kryesore në pyetjet e hapura




Kërcënimet kryesore në pyetjet e mbyllura




### Kërcënimet e brendshme të sigurisë sipas rajonit



### Kërcënimet kryesore sipas vendbanimit



### Kërcënimet kryesore sipas kombësisë





## 2.1 PERIMETRI I SIGURISË


Perimetri i sigurisë është një element si dhe tregues mjaft interesant i sigurisë publike në Kosovë. Ngjashëm me vitin e kaluar, të anketuarit janë pyetur se sa ndihen të sigurtë në shtëpi, lagje, fshat/qytet si dhe në Kosovë. QKSS-ja përdor perimetrin e sigurisë me qëllim që të paraqesim një perimetër virtual të sigurisë dhe të identifikojmë cilat janë ambientet mikro ose makro në Kosovë ku qytetarët ndjehen të pasigurt, të sigurtë dhe më së shumti të sigurtë.

Sipas të dhënave të këtij viti, qytetarët e Kosovës ndihen më së sigurti në shtëpi të tyre. 85.5% të anketuarve kanë thënë se ndihen shumë të sigurtë në shtëpitë e tyre. Krahas kësaj, 84.9% kanë raportuar se ndihen të sigurtë në lagjen e tyre. Këto dy të gjetura mundën të tregojnë se qytetarët në Kosovë ndihen përgjithësisht të sigurt sa i përket mundësisë që të ndodhin krimet e vogla.

Vërehet se qytetarët kanë një qëndrim tjetër sa i përket ndjenjës së sigurisë kur u ekspozohen ambienteve siç janë fshati,

qyteti si dhe Kosova në përgjithësi. 78.5% të anketuarve kanë thënë se ndihen shumë të sigurtë në fshatin apo qytetin e tyre. Vetëm 52.4% të të anketuarve janë shprehur se ndihen të sigurtë në Kosovë.

Nga të dhënat e BKS 2018 është e qartë se ndjenja e sigurisë fillon të zbehet sa më shumë që qytetarët largohen nga ambienti i shtëpisë së tyre, kështu duke u rritur ndjenja e pasigurisë. Një interpretim i kësaj mund të jetë që qytetarët ndihen më të sigurtë në ambientet mikro pasi që e lidhin sigurinë e tyre me krimet e vogla dhe dukuritë e tjera të cilat i shohin si më të menaxhueshme nga ata. Në anën tjetër, në ambientin makro qytetarët e lidhin ndjenjën e sigurisë, pasigurisë më shumë me dukuritë dhe rreziqet sociale-ekonomike, jostabilitetin politik të cilat i shohin si jashtë kontrollit të tyre. Kjo ndërlikueshmëri e faktorëve të cilët ndikojnë në perceptimet e qytetarëve për siguri publike do të analizohet më shumë në edicionin special të BKS-së lidhur me Sigurinë Publike që pritet të publikohet në Shkurt 2019.



---

# METODOLOGJIA

## ÇKA ËSHTE BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

---

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i krijuar në shtator të vitit 2012. Qëllimi i tij kryesor është që të mat besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë si dhe të mat perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen Kosovës.


BKS është aktiviteti i parë dhe më i madhi i këtij lloji i dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një forum lokal në Kosovë. Duhet theksuar se ajo që e bën unik BKS-në në Kosovë është neutraliteti i tij politik. Si një forum i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e çfarëdo gjetjeje dhe mesazhi të hulumtimit.

BKS përdor kombinim të metodave cilësore dhe sasimore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mblidhen përmes intervistave personale me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme që zhvillohen nga hulumtuesit e QKSS-së në terren anembanë Kosovës. Pyetësi i QKSS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të Shkallës pesë-pikëshe të Likertit, që pasoheshin me disa pyetje të hapura që u mundësonin të anketuarve të japin mendimet e tyre pa u dhënë opsione të paracaktuara të përgjigjeve.

Ekipi i QKSS-së prej 28 hulumtuesve ka bërë pilotimin dhe intervistat. Mostra në nivel vendi nga të cilat u nxor ky hulumtim përfshinte 1,085 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi moshën 18 vjeçe në Kosovë.

Përkatësia etnike e personave të intervistuar ishte: 90 për qind shqiptarë të Kosovës, 8 për qind serbë dhe 2 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptas, goranë, kroatë dhe malazez), që reflektonin përbërjen etnike të Kosovës.

Korniza e mostrës bazohej në zona sipas kodeve hyrëse telefonike dhe si e tillë përfshinte këto tetë rajone: Ferizajin, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin.



Faza e parë e grupimit gjeografik bazohej në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë 2012. Faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave për zona komunale me mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit u zhvillua sipas metodës së caktimit të rastësishëm të mostrës duke përdorur ‘metodën e ditëlindjes’ më të afërt.


Caktimi i rastësishëm i mostrës siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të zgjidhet për intervistë. Me mostrën e zgjedhur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullsisë së rritur të Kosovës në përgjithësi.

Margjina e gabimit është 3 për qind me interval të besueshmërisë prej 95 përqind.


Një intervistë testuese u zhvillua kah mesi i muajit shtator 2018 për të testuar sa është i plotë pyetësori para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues pastaj raportoi se intervista testuese ishte e suksesshme dhe se nuk ishin hasur probleme me instrumentin testues. Të gjitha intervistat u kryen nga 29 shtator deri më 5 tetor 2018. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacioneve të marra nga të anketuarit dhe ai demonstroi se si njerëzit i perceptojnë institucionet kosovare.


### Të anketuarit sipas gjinisë




### Të anketuarit sipas vendbanimit



### Hulumtimi në terren



### Mosha





Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

351.746.1(496.51)(048)

Kosovo Security Barometer : eight edition  
/ Donika Marku. – Prishtinë : Kosovar Center for Security Studies, 2018. - 32 f. : ilustr.  
; 21 cm.

1.Marku, Donika

**ISBN 978-9951-679-86-2**



[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-679-86-2



9 789951 679862